

**AKT THEMELIMI
PER KRIJIMIN SI PERSON JURIDIK TE SHOQERISE
"ERGI" SH.P.K**



Ky akt themelimi u perpilua nga ortaket themelues :

Elvis Rroshi, i biri i Tahirit, i dtl. 1975, lindur dhe banues në Kvjaje, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur personalisht prej meje noteres .
Gentian Daja, i biri i Tahirit, i dtl. 1976, lindur dhe banues në Kavaje, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur personalisht prej meje noteres.

Te quajtur me poshte ortaket themelues, te cilet ne perputhje me ligjin nr.7632, date 4/11/1992 "Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregetar", me ligjin nr.7368, date 19/11/1992 "Per shoqerite tregetare" dhe ligjin nr.7667, date 23/01/1993 "Per regjistrin tregetar", krijojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar si vijon:

I.FORMIMI

1.1. Ortaket themelues formojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me ligjin nr.7638, date 19/11/1992 "Per shoqerite tregetare"

1.2.Emri i Shoqerise

Emri i shoqerise do te jete **"ERGI" SH.P.K**

1.3. Selia e Shoqerise



Shoqeria **"ERGI" SH.P.K** do te kete qendren e veprimtarise se saj ne qytetin e Kavajes me adrese Rr. "Josif Buda"

1.4. Kohezgjatja e Shoqerise

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete i papercaktuar. Me vullnetin e asamblese se ortakeve, kjo shoqeri mund te mbyllet edhe para afatit, ne rastet kur kjo shoqeri humbet efektivitetin ekonomik per ortaket.

1.5 - Afati i veprimtarise se shoqerise

Afati i veprimtarise se shoqerise do te jete i papercaktuar. Si dite fillestare do te merret data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Tiranës.



1.6. Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te per objekt te veprimtarise se saj ndertimin, investimin, rikonstruksionin e godinave civile, industriale, turistike, bujqesore, ujesjellesa kanalizime, rrugeve, veprave te ndryshme te artit ne fushen e ndertimit etj, sipas licensave profesionale te drejtuesit teknik te shoqerise.

Import eksport, te materialeve te ndryshem qe kane lidhje me objektin e veprimtarise. Import eksport e tregetim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem industriale te perdorimit te gjere, konfeksione tekstile, pajisje elektroshtepiake, hidrosanitare, materiale ndertimi, artikuj mobilerie per mobilime zyresh hotelesh motelesh etj, artikuj kancelarie, pllake per shtrim e veshje, punime duralunimi, e punim pllaka gipsi.

II. KAPITALI

2.1. - Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 300.000 (treqind mije) Leke kontribut i ortakeve themelues ne masen:

Elvis Rroshi 50 % Gentian Daja 50 %

Asambleja e ortakeve ka te drejte te beje shtese te kapitalit themeltar te shoqerise.

2.2 - Fitimi

Fitmi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve themelues ne masen:

Elvis Rroshi 50 % Gentian Daja 50 %

III. STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE


3.1 Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e ortakeve .
- Administratori i shoqerise.

Administratore te shoqerise do te jene bashkarisht te dy ortaket themelues Elvis Rroshi dhe Gentian Daja.

IV. DISPOZITE E FUNDIT


4.1. Ndryshimet ne kete AKT mund te behen vetem me shtese me shkrim dhe te miratuar nga asambleja e ortakeve.



Pjesë e pandare e ketij akti eshte statuti i shoqerise i cili nenshkruhet rregullisht nga themeluesit e shoqerise.

4.2. Ky akt themelimi u hartua ne 4 kopje origjinale, i cili nenshkruhet rregullisht konform ligjes.

THEMELUESIT

1. ELVIS RROSHI 
.....

2. GENCIAN DASA 
.....

**STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ERGI" SH.P.K**



Ky statut perpilohet nga :

Elvis Rroshi, i biri i Tahirit, i dtl. 1975, lindur dhe banues në Kvjaje, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur personalisht prej meje noteres .

Gentian Daja, i biri i Tahirit, i dtl. 1976, lindur dhe banues në Kavaje, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur personalisht prej meje noteres.

Te quajtur me poshte ortake themelues, me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me me ligjin Nr.7632, date 4.11.1992 " Per dispozitat qe rregullojne pjesen e pare te Kodit Tregtar", me ligjin Nr. 7638, date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare ", si dhe me aktet e tjera te legjislacionit shqiptar qe trajtojne keto ceshtje, krijon nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, si vijon:

**KREU I
NENI 1
FORMA**

Ortaket e mesiperm krijojne nje Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Shqiperi dhe me dispozitat e ketij Statuti.

**NENI 2
EMRI I SHOQERISE**

Emri i shoqerise do te jete **"ERGI" SH.P.K**

**NENI 3
SELIA E SHOQERISE**

Selia qendrore e shoqerise do te jete ne qytetin e Kavajes me adrese Rr."Josif Budo" . Shoqeria ka te drejte qe me vendim te asamblese se ortakeve mund te hape dege. zyra, filiale ose perfaqesi te shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise.

**NENI 4
KOHEZGJATJA**



Shoqeria do te kete kohezgjatje te papercaktuar Si date fillestare merret data e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria do te per objekt te veprimtarise se saj ndertimin, investimin, rikonstruksionin e godinave civile, industriale, turistike, bujqesore, ujesjellesa kanalizime, rugeve, veprave te ndryshme te artit ne fushen e ndertimit etj, sipas licensave profesionale te drejtuesit teknik te shoqerise.

Import eksport, te materialeve te ndryshem qe kane lidhje me objektin e veprimtarise. Import eksport e tregetim me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem industriale te perdorimit te gjere, konfeksione tekstile, pajisje elektroshtepiake, hidrosanitare, materiale ndertimi, artikuj mobilerie per mobilime zyresh hotelesh motelesh etj, artikuj kancelarie, pllake per shtrim e veshje, punime duralunimi, e punim pllaka gipsi.

KREU II KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMI

NENI 6

Kapitali themltar shoqerise eshte 300,000 (treqind mije) Leke.

NENI 7 KONTRIBUTET

Kontributi percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti i takon ortakeve themelues ne masen : Elvis Rroshi 50 % Gentian Daja 50 %


NENI 8

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqerise i takon ortakeve themelues ne masen: Elvis Rroshi 50 % Gentian Daja 50 %

NENI 9

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR





Kuotat e kapitalit te shoqerise mund te transferohen me ane aktesh mes te gjalleve dhe me trashegimi. Transferimi i kuotave te kapitalit te shoqerise nuk i nenshtrohet asnje lloj kufizimi, ne qofte se ndodh ne rast vdekjeje.

KREU III

MARRJA E VENDIMEVE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 10

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve organizon, drejton dhe kontrollon gjithe aktivitetin e shoqerise. Ortaket perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributit te secilit.

NENI 11

DREJTIMI SHOQERISE



Organi me i larte drejtues i shoqerise do te jete asambleja e ortakeve. Asambleja e ortakeve mblidhet si rregull dy here ne vit, si dhe sa here qe gjykohet e arsyeshme. Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne vendime dhe disponon nje numer votash te barabarte me pjesen e kapitalit themeltar qe ai zoteron.


NENI 12

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Asambleja e ortakeve vendos per keto ceshtje:

- Emeron administratorin e shoqerise.
- Emeron ekspertet kontabel.
- Miraton bilancin vjetor.
- Vendos per shperndarjen e dividendit te shoqerise.
- Ben ndryshime ne statut.
- Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.



- 
- Ne rast te shperndarjes se shoqerise cakton likujdatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likujdimi.
 - Vendimet e asamblese nenshkruhen nga ortaket dhe vertetohen nga noteri.

NENI 13 ADMINISTRATORI

Shoqeria do te administrohet bashkarisht nga te dy ortaket themelues Elvis Rroshi dhe Gentian Daja.

NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori i shoqerise emerohet nga asambleja e ortakeve te cilet pergjigjen per zbatimin e vendimeve te asamblese se ortakeve

Administratoret kane keto kompetenca :


- Te bejne drejtimin e shoqerise .
- Te perpilojne dhe nenshkruajne kontratat dhe aktet juridike qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise;
- Te hapin llogari rrjedhese bankare prane bankave shqiptare ose te huaja.
- Te perfaqesojne shoqerine ne mardhenie me te tretet.
- Te emerojne nenpunes te rangjeve te ndryshme per veprime te vecanta teknike ose per nje kategori te caktuar veprimesh;
- Te bejne gjithcka tjeter qe konsiderojne te dobishme dhe qe eshte ne perputhje me formen e ketij Statuti e te Aktit Themelues si dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi, per te arritur qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.

KREUI V LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 15

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec dokumentacinit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra:

Gentian Daja *Elvis Rroshi*

- 
- 1- Libri i ortakeve, ne te cilin shenohen emrat e plote te Ortakeve dhe kuotat qe secili ka ne kapitalin e themelimit.
 - 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te asamblese.
 - 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Admimstratoreve.
 - 4- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te organit sindikal.

NENI 16
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI
KONTABEL

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar mund te filloje pas regjistrimit te shoqerise si person juridik dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor 2006. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e veçanta te hartuara nga admimstratori miratohen nga asambleja e ortakeve. Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

KREU V
NENI 17
AKTIVITETI FINANCIAR

Ne çdo mbyllje te çdo viti financiar administratori ben inventarin dhe llogarine vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin, si dhe hartohet nje raport me shkrim Bilancit i bashkengjiten:


- a. Nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria,
- b. Nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria,


Raporti i administratoreve perfshi gjendjen gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e mundshme qe jane zhvilluar nga data e mbylljes se vitit financiar deri ne ditën qe eshte hartuar ky raport. Dokumentet vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten nje muaj para mbledhjes se asamblese.

NENI 18

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise, detyrimet fiskale, shoqerore, demet, amortizimet, etj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi.





Perberja, shuma e pergjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdorimi dhe rregullmi i çdo fondi te veçante caktohet nga asambleja e ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Ne perputhje me Nenin 213 te ligjit " Per shoqerite tregtare " nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar lihet menjane nje shume me vlere 1/20 e cila destinohet per krijimin e nje fondi "rezerve e domosdoshme".

NENI 19 PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria priset per arsye te parashikuara ne ligj. Shoqeria priset perpara afatit me vendim te Asamblese Ortakeve .

NENI 20

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise behet ne perputhje me dispozitat e ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

NENI 21


Kur shoqeria priset ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi " Shoqeri ne likujdim e siper ". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit. Prishja e shoqerise eshte me pasoje ndaj te treteve vetem pas publikimit te prishjes ne regjistrin tregtar.

NENI 22

Per te perfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e ortakeve emerone nje ose disa persona si likujdues te cilet perfaqesojne shoqerise. Likuiduesi perpilon bilancin financiar likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise dhe ndan tepricat ne dispozicion.

NENI 23

Ne perfundim te mbylljes se likujdimit, ortaket thirren qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar, per aktin e rregullshmerise, per admimstrimin e tij nga ana e likujduesit dhe per heqjen e mandatit te



likuiduesit, si dhe per t'u evidencuar mbyllja e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja e Ortakeve .

NENI 24

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen pronareve.

Mjetet fmanciare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena pasi te jene likujduar kreditoret.

NENI 25

DISPOZITA TE FUNDIT

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Pumesimi behet sipas kushteve te percaktuara ne legjislacionin e punes se Republikes se Shqiperise, si dhe rregullave te vena ne kontraten e vecante te punesimit qe lidhet midis punedhenesit e punonjesit. Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Kur mosmarreveshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim kompetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres.

NENI 26

Ky statut firmoset me vullnetin e lire te ortakeve themelues.

THEMELUESIT

1. ELVIS RROSHI ~~ELVIS RROSHI~~

2. GENTIAN DASA ~~GENTIAN DASA~~

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 3847 Rep, Nr. 1080 kol.



VERTETIM

Ne Tirane, sot me daten ...06.10.../2006 (dymije e gjashte) ne zyren e noterise Tirane, para meje Noteres Elida magani u paraqit personalisht: ----

Elvis Rroshi, i biri i Tahirit, i dtl. 1975, lindur dhe banues në Kvaeje, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur personalisht prej meje noterës .
Gentian Daja, i biri i Tahirit, i dtl. 1976, lindur dhe banues në Kavaje, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, i njohur personalisht prej meje noterës.

Te sipershenuarit deklarojne se kane redaktuar kete Statut per regjistrimin e shoqerise "Ergi" sh.p.k, me vullnetin e tyre te lire e nenshkruan rregullisht para meje dhe une Noter e vertetoj me nenshkrimin tim dhe vulen e noterit publik.

NOTERE
ELIDA MAGANI